

VENDIM
Nr. 356, datë 29.4.2015

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES
TE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE, PËR DREJTORINË E ARKIVIT
SHTETËROR VENDOR NË DIBËR, DEGA E ARKIVIT NË BURREL, TË PRONËS NR.
716, ME EMËRTIM “QENDËR MOBILIZIMI”, ME VENDNDODHJE NË BURREL, DHE
PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, (PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar; me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, për Drejtorinë e Arkivit Shtetëror Vendor në Dibër, dega e Arkivit në Burrel, të pronës nr. 716, me emërtim “Qendër mobilizimi”, me vendndodhje në Burrel, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, për t’u përdorur për administrimin, ruajtjen dhe përpunimin e dokumentacionit shtetëror.

2. Prona nr. 716, me emërtim “Qendër mobilizimi”, me vendndodhje në Burrel, e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 660, datë 4.8.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”.

3. Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, Drejtorisë së Arkivit Shtetëror Vendor në Dibër, degës së Arkivit në Burrel, u ndalohet ta ndryshojnë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, drejtori i Përgjithshëm i Arkivave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLAN VENDOSJA E DEGES USHTARAKE BURREL

SISTEMI I KOORDINATEVE LOKALE



PUNCI MAJ 2004
MAJOR R. HAXHIMAJOR S. LLESHI
MAJOR ING. ILIR CEXREZI
SHEFI I DEGES GJEDEZISE

DR. MYKALIM PASHA
DREKTOR I L.G.J. URBAN